

PRURJE LEKSIKORE DHE LEKSIKOGRAFIKE NË FUSHË TË SHQIPES

JAVA E ALBANOLOGJISË 6, Instituti Albanologjik, Prishtinë,
15-19 qershor 2015

Instituti Albanologjik i Prishtinës, më 15-19 qershor 2015, zhvilloi veprimtarinë e gjashtë shkencore, tashmë tradicionale, "Java e albanologjisë". Në këtë konferencë u paraqiten me punime e ndihmesa shkencore studiues nga institucione të ndryshme albanologjike, nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e nga Mali i Zi, të cilët, së bashku me diskutimet, sollën të dhëna, analiza e përfundime shkencore të reja e të rëndësishme në fushat përkatëse.

Në hapje të "Javës së albanologjisë", me një fjalë rasti, pjesëmarrësve iu drejtua drejtori i Institutit Albanologjik, prof. Hysen Matoshi e më pas edhe ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, prof. Arsim Bajrami. Në vijim u bë përrurimi i botimeve të Institutit Albanologjik të Prishtinës gjatë vitit 2014, të cilat i paraqiti prof. Lulëzim Lajçi, sekretar shkencor i IAP-it.

Në sesionin shkencor të Degës së Gjuhësisë temë bosht ishte "Prurje leksikore dhe leksikografike në fushë të shqipes". Në këtë sesion lexuan kumtesa shkencore studiuesit: Jani Thomai "Lëvizjet prapavajtëse në leksikon e gjuhës së sotme shqipe", ku, ndër tjera, u theksua se në fushën e mbledhjes dhe të pasurimit të fondit leksikor të shqipes janë bërë punë të vyeshme, por janë shënuar edhe hapa me prirje prapavajtëse. "Mbledhja e leksikut drejtpërdrejt nga goja e popullit, theksoi ai, ka qenë një nga përparësitë kryesore të gjuhësisë shqiptare. Sot nuk është më në ato përmasa as si praktikë e kërkimit gjuhësor. Pasojë e këtij zhvillimi është edhe dobësimi i vëzhgimit dhe i regjistrimit të leksikut të ligjërimeve popullore, ekspeditat leksikologjike në terren për të mbledhur fjalë shqipe të rralla janë ndërprerë, edhe për arsye se "nuk ndihen më të domosdoshme".

Qemal Muratit mbajti kumtesën “*Leksiku dhe leksikografia shqiptare në vështrimin e sotëm – rezultate dhe probleme*”, ku theksoi se leksikologjia shqiptare ende ka zbrazëti që duhen plotësuar, sepse “*po të bënim një krahasim me gjuhët e me kulturat e tjera, do të mund të shihnim se tek fqinjët tanë leksikografia ka arritje më të konsoliduara*”.

Me temën “*Prania e arabizmave në leksikun e shqipes*” mbajti kumtesën studiuesi Xhevat Lloshi, i cili theksoi se “*njohja e drejtpërdrejtë e shqiptarëve me arabët, rrjedhimisht edhe me gjuhën e tyre të folur, ka ndodhur mjaft vonë, shkrimi i tyre është bërë i pranishëm në Shqipëri shumë më heret, që në fillimet e sundimit turk, në shek. XV. Fjalë shqipe dalin për herë të parë me alfabetin arab te vepra e E. Çelebiut që në shek. XVII*”. Sipas tij “*ndërkombëtarizmat arabë nuk janë arabizma të shqipes, por huazime ndërkombëtare, për të cilat parimi shkencor i leksikologjisë historike e kërkon që të gjurmohet prej cilës gjuhë na kanë ardhur dhe në cilën datë*”; ai shton se “*do të quajmë arabizma fjalët, të cilat shqipja i ka marrë prej arabishtes dhe jo prej gjuhësh të tjera. Rrjedhimisht, e nënkuptojmë që shqipja ka pasur edhe kontakte të drejtpërdrejta me arabishten, pa ndërmjetësi, jo tërthorazi*”.

Rahmi Memushaj, në kumtesën e vet “*Sintetizmi si prirje edhe e proceseve fjalëformuese të shqipes*”, theksoi se “*në ligjërimin e shkruar të shqipes po parapëlqehet gjithnjë e më shumë prirja për t’i shprehur konceptet teorike apo lidhjet e koncepteve në mënyrë sintetike, d.m.th. me fjalë të prejardhura, të përbëra e të përngjitura, në vend të sintagmave emërore e parafrallore që janë përdorur më parë. Kjo prirje në mjaft raste shpie edhe në formimin me tepri të fjalëve të reja të panevojshme ose të përçudnuara*”.

Valter Memisha, në kumtesën “*Fjalëformimi dhe sistemësia në fjalorët shpjegues të shqipes*”, pohoi se “*rruga kryesore e pasurimit të shqipes bashkëkohore është fjalëformimi. Mbështetur në gjedhet e brendshme dhe me anë të mjeteve fjalëformuese, gjuha sot ka rritur ndjeshëm numrin e fjalëve të reja të hedhura në përdorim nga subjekte të ndryshme, por sidomos nga shkrimtarët (Kadare, Qose etj.), nga punonjësit e medieeve (të shkruara), nga përkthyesit, nga dijetarët (që vlerësohen për shqipërimin e termave të shumtë a për krijimin e termave të rinj), gjuhëtarët që ndjekin ligjet e ligjësitë e fjalëformimit të shqipes etj.*”.

Sesioni shkencor i Gjuhësisë vijoi punimet me kumtesat shkencore të studiuesve Emil Lafe, “*Vështrim i përgjithshëm tematik e statistikor i zërave persona në “Fjalorin enciklopedik shqiptar” (FESH) të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (3 vëllime, Tiranë, 2008-2009)*”; Zeqirija Ibra-

himi, "Probleme të terminologjisë islame në gjuhën shqipe"; Kujtim Kapllani, "Prurjet e reja të mos cenojnë tiparet popullore dhe intelektualizmin e shqipes"; Idriz Metani, "Zhvillime të reja në terminologjinë shqipe të gjuhësisë"; Mimoza Priku - Anisa Kosteri, "Fjalorët e shkrimtarëve të mëdhenj - bazë e rëndësishme për një fjalor thesarus të shqipes"; Agron Duro - Gani Pllana, "Marrëdhëniet logjike ndërmjet shenjave njëfjalëshe e togfjalëshe"; Rrezarta Draçini, "Përfaqësimi i dijes konceptuale e leksikore përballë qasjes së folësit ndaj shtresës dialektore"; Mustafa Ibrahim, "Kuptimi metaforik i disa termave gjatë ligjërimit bisedor dhe atij të shkujdesur"; Edlira Troplini-Abdurrahmani, "Prurjet leksikore në kuadër të 'relativitetit' semantik"; Suela Kastrati, "Frazeologjia në poemën 'Këngët e Milosaos' të De Radës si shprehje e veçorive gjuhësore e kulturore të ligjërimeve arbëreshe"; Isa Bajçinca, "Vëzhgime për 'Fjalorin popullor' të Abdullah Zymberit"; Ragip Mulaku, "Prurje të reja leksikore në 'Fjalorin popullor' të Abdullah Zymberit"; Abdulla Zymberi, "Leksiku të romani 'Tan Temali' i Ilir Shaqirit"; Aida Kurani, "Veçori fjalëformuese të fjalësit në Fjalorin e Nikollë Gazullit 'Fjalorthi i ri - fjalë të rralla të përdoruna në Veri të Shqipërisë"; Xhafer Beqiraj, "Një tufëz fjalësh karakteristike nga treva e Opojës"; Avdyl Sulaj, "Disa momente nga përvoja ime në lëmin e leksikografisë"; Helena Grillo, "Prurje leksikore në 'Mëngjeset në Kafë Rostand' të I. Kadaresë"; Haredin Xhaferi, "Një klasifikim i lokucioneve ndajfoljore me strukturë trifjalëshe në gjuhën shqipe"; Manjola Zaçellari, "Fushat kryesore konceptore të frazeologjisë së gjuhës shqipes"; Fridrik Dulaj, "Rreth disa veçorive gjuhësore në leksikun e Rahovecit me rrethinë (Krahasim me hartat e Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe)"; Migena Arllati, "Mendësia dhe shprehësia në frazeologjinë e të folmes së Gjakovës"; Shkëlqim Millaku, "Kompozitat në Fjalorin e Gjuhës Shqipe të Mehmet Elezit"; Senad Neziri, "Vëzhgime mbi leksikun e Prizrenit me rrethinë"; Afërdita Abdullahi, "Marrëdhëniet e leksikut dialektor me leksikun e shqipes standarde"; Vjosa Osmani, "Leksiku në anekdota popullore të mbledhura nga Mehmet Rukiqi"; Shpresa Ismajli, "Leksiku me ngjyrim emocionues në trevën e Llapit"; Sejdi Gashi, "Materiale leksikore nga e folmja e Istogut me rrethina"; Abdurrahim Maxhuni, "Emërtimet e kafshëve sipas ngjyrës në të folmen e Vushtrrisë"; Shemsi Haziri, "Dallimet terminologjike në Ligjin e Policisë së Shtetit dhe Ligjin e Policisë së Kosovës dhe ca prurje të reja".

Sejdi M. GASHI